

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 299/I prot.

Shkodër, më 04.04.2023

**Lënda:** Mbi Vendimin nr. 30, datë 29.03.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**


Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, neni 56, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 29, neni 37, pika 1, shkronja “c”, neni 54, shkronja “dh”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, shkronja “gj”, neni 41, pika 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, të Udhezimit nr. 3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2016”, të shkreses së Këshillit Bashkiak Vau Dejës Nr.2393 prot., datë 04.04.2023 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës të datës 29.03.2023”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 30, datë 29.03.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare familjes së z. Veli Haxhija që i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë me dt. 08.02.2023, sipas Vertetimit për rënie zjarri të MZSH nr. 2, datë 06.03.2023”, me ndihmë financiare z. Veli Haxhija në shumën prej 2.537.028 lekë, nga programi 3280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”, nga buxheti i vitit 2023 të Bashkisë Vau Dejës.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 30 datë 29.03.2023

**Dhënie ndihme financiare familjes së z.Veli Hamid Haxhija që i është dëmtuar banesa si pasoje e zjarrit të rene me dt.08.02.2023**

**Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave , për vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.84 dt.23.12.2022 “Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2023”konfirmuar nga Prefektura Shkoder me shkresën Nr.24/1 dt.12.01.2023, si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.1 dt.16.02.2023, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasin **Veli Hamid Haxhija** banorë i fshatit Barbullush të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës:

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilësuar votash,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin** e proces verbalit të konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, të hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e kryetarit te Bashkisë Nr.50 prot dt.10.02.2023 në vlerën totale **5.074.056** (Pesëmilion e shtatedhjetë e katër mije e pesëdhjetë e gjashtë ) lekë për shtetasin **Veli Hamid Haxhija** banorë i fshatit Barbullush të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës .
- 2. Miratimin** e dhënies së ndihmës financiare për shtetasin **Veli Haxhija** banorë i fshatit **Barbullush** të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **2.537.028** (Dymilion e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëzet e tetë ) lekë në masën **50%** të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia e saj me dt.08.02.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
4. **Burimi i financimit :**Fondi i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në Buxhetin e Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.84 dt.23.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023.
5. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances ) për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

**KRYETAR**

*Mark Bisha*

Sekretari i Këshillit Bashkiak

*Arjana Çelaj*

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.04.2023